




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-6871/23 datë:10.03.2023



Npi – 01/79 datë: 15.03.2023

Bazuar në nenin 40.2. pika (d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Në Ligjin Nr.05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.17/10, Qershor 2016); Nenin 14 të Rregullores së Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit Nr.01/02-1163 e datës 21.06.2019. Kuvendi Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 15.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË
AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR VITIN 2021**

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më datën: 15.03.2023 unanimisht miratoi, Raportin për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021, sipas planit për zbatimin e rekomandimeve.

II

Raporti është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, Ministrisë për Financa, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi